



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Paneli i Përbërë prej Gjykatësit të Vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratorja: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 dhjetor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

VENDIM

Për Gjuhën e Punës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

GJYKATËSI I VETËM në bazë të nenit 20 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 8(3)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon Vendimin për Gjuhën e Punës.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 maj 2018, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Dhomat e Specializuara”) caktoi Gjykatësin e Vetëm në procesin gjyqësor KSC-BC-2018-01 për të shqyrtuar kërkesat për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to të parashtruar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) përpara ngritjes së aktakuzës dhe caktimit në vijim të gjykatësit të procedurës paraprake në bazë të nenit 33(1)(a) të Ligjit.¹

2. Më 8 nëntor 2019, Gjykatësi i Vetëm informoi Prokurorin e Specializuar se synonte të lëshonte vendimin për gjuhën e punës, në të cilin anglishtja do të caktohet si gjuhë e punës që do të përdoret në procesin KSC-BC-2018-01. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm ftoi Prokurorin e Specializuar të dorëzonte parashtrime në lidhje me këtë aspekt dhe të sillte në vëmendje të Gjykatësit të Vetëm problemet që mund të parasheh në lidhje me burimet e përkthimit dhe aspekteve që kanë të bëjnë me të.²

3. Më 19 nëntor 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi parashtrimet, ku pajtohej me Gjykatësin e Vetëm se gjuha e punës për procesin KSC-BC-2018-01 duhet të jetë anglishtja.³ Prokurori i Specializuar theksoi se ky veprim përputhet me

¹ KSCPR-2018/F00004, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Një Gjykatësi të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit* (“Vendimi për Caktimin”), 29 maj 2018.

² KSC-BC-2018-01/F00072, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër Prokurorit të Specializuar për Parashtrime në lidhje me Gjuhën e Punës*, 8 nëntor 2019, para. 3.

³ KSC-BC-2018-01/F00074, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Gjuhën (Gjuhët) e Punës për KSC-BC-2018-01* (“Parashtrimi i ZPS-së”), 19 nëntor 2019, para. 2.

sigurimin e proceseve të efektshme, ndërsa pasqyron shpërndarjen praktike dhe të përgjegjshme të burimeve.⁴

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja, dhe në çdo procedurë, paneli mund të vendosë për gjuhën e punës gjatë procedurës, sipas nevojës dhe duke respektuar në tërësi të drejtat e të akuzuarve.

5. Sipas rregullës 8(3)(a) të Rregullores, duke marrë parasysh nenin 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtjen e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

III. DISKUTIM

A. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

6. Neni 20 i Ligjit e lejon Gjykatësin e Vetëm që të miratojë vendim për gjuhët e punës në cilëndo “procedurën”. As Ligji e as Rregullorja nuk e përkufizojnë “procedurën”. Termi përkufizohet si “ecuri e rregullt dhe me rend e një padie, përfshirë të gjitha veprimet dhe ngjarjet gjatë kohës midis fillimit dhe shqiptimit të aktgjykimit,”⁵ ose përgjithësisht si “çështje juridike në shqyrtim para një Dhome”.⁶ Kryetarja caktoi Gjykatësin e Vetëm për të shqyrtuar të gjitha kërkesat për autorizim gjyqësor dhe

⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

⁵ Black's Law Dictionary, Abridged 10th Edition, Garner (Ed.), 2015, p. 1019.

⁶ *Shih* International Criminal Court, *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, Appeals Chamber, Judgment on victim participation in the investigation stage of the proceedings in the appeal of the OPCD against the decision of Pre-Trial Chamber I of 7 December 2007 and in the appeals of the OPCD and the Prosecutor against the decision of Pre-Trial Chamber I of 24 December 2007, 19 December 2008, ICC-01/04-556, para. 45.

çështje lidhur me të, të parashtruara nga Prokurori i Specializuar para dorëzimit të një aktakuze, d.m.th. në fazën e hetimit.⁷ “Procedurat” gjyqësore kryhen kur Gjykatësit të Vetëm i kërkohet të vendos lidhur me këto kërkesa dhe çështje lidhur me to.⁸ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm mund të lëshojë vendim për gjuhën e punës në procesin KSC-BC-2018-01.

7. Në kontekst të procedurave gjyqësore gjatë fazës së hetimeve parashtrimet dhe materiali mbështetës në lidhje me to dorëzohen kryesisht nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), pala e vetme në procesin KSC-BC-2018-01. Duke pasur parasysh se nuk janë ngritur akuza ndaj asnjë të dyshuari, gjuha që flasin ata nuk mund të merret parasysh.

8. Për këtë arsye, ZPS-ja ka dorëzuar të gjitha parashtrimet në anglishte. Gjithashtu, të gjitha vendimet dhe urdhrat e lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm janë dorëzuar në anglishte.

9. Duke pasur parasysh mandatin e Dhomave të Specializuara për të garantuar, ndër të tjera, procedura penale efikase, sikurse përcaktohet në nenin 1(2) të Ligjit, rregullimi i gjuhës së punës në këtë proces penal është i domosdoshëm për të shmangur vonesa të konsiderueshme gjatë procesit të analizimit dhe vendimmarrjes. Gjithashtu, është e nevojshme që të jepet sqarim për Prokurorin e Specializuar dhe çdo pjesëmarrës, sipas rastit, lidhur me përgatitjen dhe organizimin e parashtrimeve të tyre. Tutje, përcaktimi i gjuhës së punës do të shtojë parashikueshmërinë dhe aftësinë

⁷ Vendimi për Caktimin, para. 16. Gjykatësi i Vetëm thekson se është përcaktuar që faza e hetimit është faza “para vetë çështjes gjyqësore, gjatë të cilës nuk ka të pandehur, duke pasur parasysh se nuk janë lëshuar fletarrestime ose fletëthirrje për paraqitje ndaj asnjë personi”, shih International Criminal Court, *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, Pre-Trial Chamber I, Decision on the Prosecution’s Application for Leave to Appeal the Chamber’s Decision of 17 January 2006 on the Applications for Participation in the Proceedings of VPRS 1, VPRS 2, VPRS 3, VPRS 4, VPRS 5 and VPRS 6, 31 March 2006, ICC-01/04-135-tEN, para. 36.

⁸ *Ngjashëm*, International Criminal Court, *Situation in the Republic of Kenya*, Pre-Trial Chamber II, Decision on Victims’ Participation in Proceedings Related to the Situation in the Republic of Kenya, 3 November 2010, ICC-01/09-24, para. 9; *Situation in the Democratic Republic of the Congo*, Pre-Trial Chamber I, Decision on victims’ participation in proceedings relating to the situation in the Democratic Republic of the Congo, 11 April 2011, ICC-01/04-593, paras 9-10.

për planifikim për njësitë e shërbimeve gjuhësore të Zyrës Administrative dhe ZPS-së.

10. Së fundi, Gjykatësi i Vetëm vëren se ZPS-ja ka shërbim gjuhësor të brendshëm. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Vetëm nuk do të kërkojë si parim që përkthimet të bëhen nga Njësia e Përkthimeve e Zyrës Administrative ("NJP").

B. PËRCAKTIMI I GJUHËS SË PUNËS

11. Për procesin KSC-BC-2018-01, anglishtja caktohet të jetë gjuha e punës. Rrjedhimisht, Prokurori i Specializuar paraqet parashtrimet në anglishte. Nëse shtojcat, materiali mbështetës apo provat tjera në të cilat mbështetet Prokurori i Specializuar në tërësi apo pjesërisht, janë në gjuhë të ndryshme nga anglishtja, duhet të bëhet përkthimi i këtyre materialeve në anglishte.

C. ZBATIMI PRAKTIK

12. Për zbatimin praktik të përcaktimit të lartpërmendur, Prokurorit të Specializuar i jepen urdhrat e mëposhtme, sipas rrethanave. Udhëzimet janë organizuar në dy faza kur përkthimi nevojitet:

- (1) *Rregull i përgjithshëm*: udhëzimet para paraqitjes së parashtrimeve, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat; dhe
- (2) *Përjashtim*: udhëzimet pas paraqitjes së parashtrimeve, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat.

Në fund, përshkruhet procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me përkthimet.

1. Udhëzime për fazën para paraqitjes së parashtrimit

13. Prokurori i Specializuar ka obligim që, në parim të veprojë në përputhje me udhëzimet në vijim *para* paraqitjes së çfarëdo parashtrimi, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës apo provat e tjera.

14. Prokurori i Specializuar duhet të paraqesë parashtrimet në anglishte. Kur pjesë të tekstit, qoftë në pjesën kryesore të tekstit apo në shënimet në fund të faqes, janë në gjuhë tjetër nga anglishtja, Prokurori i Specializuar duhet të japë përkthimin në anglishte të këtyre.

15. I njëjti kriter gjuhësor vlen për shtojcat, materialin mbështetës ose provat e tjera të paraqitura në të cilat mbështetet Prokurori i Specializuar. Kjo vlen për materialin e krijuar nga Prokurori i Specializuar, ose të mbledhur nga burime tjera. Për të mbajtur në dokumentacionin e procesit vetëm materialet me rëndësi, nuk është e nevojshme që të paraqiten materialet e plota nëse Prokurori i Specializuar mbështetet vetëm në disa pjesë të tyre. Në rastet kur një dokument nuk mund të ndahet dhe Prokurori i Specializuar mbështetet vetëm në pjesë të caktuara të tij, duhet të shënohet pjesa, faqja, paragrafi ose fjalia në të cilën ai mbështetet dhe duhet të jepet përkthimi në anglishte i pjesës në fjalë.

16. Sa i përket çfarëdo parashtrimi, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës të paraqitur nga individë, autoritetet kosovare, shtetet e treta apo organizata ndërkombëtare, vlejné këto kritere:

(1) Një parashtrim, përfshirë shtojcat dhe materialin mbështetës i paraqitur nga individë kosovarë ose autoritetet kosovare mund të paraqitet në anglishte, shqipe apo serbishte;

(2) Një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës i paraqitur nga individë nga shtete të treta ose autoritetet a tyre, ose nga një organizatë ndërkombëtare mund të paraqitet në anglisht ose në çdo gjuhë tjetër të zgjedhur ose gjuhë zyrtare;

(3) Nëse një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materialin mbështetës i drejtohet Panelit, ai shpërndahet nga Zyra Administrative. Është përgjegjësi e Zyrës Administrative që të sigurojë përkthimin në anglishte të çdo parashtrimit të protokolluar, përfshirë të shtojcave, dhe materialit të paraqitur në këtë mënyrë.

(4) Nëse një parashtrim, përfshirë shtojcat, dhe materiali mbështetës, nga individë, autoritetet kosovare, shtetet e treta apo organizata ndërkombëtare dorëzohet nga ZSP-ja, është përgjegjësi e saj të sigurojë përkthimin e tyre para se t'ia dorëzojë panelit.

17. Në rastin e audiomaterialeve, videomaterialeve dhe materialeve në Internet, palët dhe pjesëmarrësit, sipas rastit, nuk mund të bazohen në atë material pa paraqitur transkriptimin e tij. Për materiale të tilla, në të cilat mbështetet Prokurori i Specializuar ose pjesëmarrësi, sipas rastit, duhet të sigurohen këto të dhëna:

- (1) sipas rastit, burimi relevant në Internet, dhe data e koha kur është parë për herë të fundit;
- (2) segmenti i saktë kohor ose fragmenti i tekstit, sipas rastit, në të cilin bazohet pala apo pjesëmarrësi, sipas rastit;
- (3) transkripti i fragmentit relevant në gjuhën origjinale, qoftë në parashtrimin kryesor apo shtojcat e tij; dhe
- (4) nëse është paraqitur nga Prokurori i Specializuar, përkthimi në anglishte i fragmentit të transkriptuar.

18. Në parim, preferohen përkthimet e përgatitura nga përkthyes të kualifikuar, qoftë brenda NJP-së, qoftë nga shërbimi gjuhësor i ZSP-së. Sidoqoftë, Gjykatësi i Vetëm është i vetëdijshëm se, në raste të caktuara, si në raste urgjente apo kur përkthyesit e kualifikuar nuk janë në dispozicion, mund të pranohen edhe përkthime të tjera.⁹

⁹ *Shih* Parashtrimet e ZPS-së, para. 4.

19. Siç parashihet në pjesën 4(2) të Udhëzuesit për përkthimet me shkrim dhe me gojë të Zyrës Administrative (KSC-BD-13) (“Udhëzuesi”), përkthimet e ofruara nga NJP-ja do të cilësohen si “version pune”, i “paredaktuar” ose “zyrtar”.

20. Kur përkthimi vjen nga ZSP-ja dhe është përgatitur nga përkthyes të kualifikuar ose nga personeli tjetër i kualifikuar, ai përkthim cilësohet si “Përkthim i ZSP-së”. Kur përkthimi i dhënë nga ZPS-ja është përgatitur nga të tjerët, si për shembull ndonjë institucion gjyqësor ose përkthyes të jashtëm të pakualifikuar, ai nuk mund të mbajë cilësimin.¹⁰ Cilësimi i drejtë i përkthimeve (apo mungesa e tyre) mbetet përgjegjësi e ZPS-së. Është nën kompetencën e Gjykatës të Vetëm që të kërkojë më vonë verifikimin nga NJP-ja, të çdo përkthimi të dorëzuar nga ZPS-ja.

21. Megjithëse ZSP-ja ka shërbimin e vet gjuhësor, këshillohet që të koordinohet dhe të bashkëpunojë me NJP-në për aspekte të përkthimit, për të shpejtuar procedurat dhe maksimizuar efikasitetin.¹¹ Çdo kërkesë për përkthim drejtuar NJP-së bëhet paraprakisht, në kohë të mjaftueshme dhe në pajtim me protokollin ekzistues për përdorimin e programit kompjuterik për përkthim *FLOW*, për të mundësuar përkthim dhe redaktim të duhur të elementeve të tekstit në fjalë.

2. Udhëzime për fazën pas paraqitjes së parashtrimeve

22. Nëse një parashtrim i protokolluar, ose pjesë të tij, është paraqitur në një gjuhë tjetër nga anglishtja, atëherë Njësia për Administrimin Gjyqësor (“NJAGJ”) kërkon përkthimin e tij përmes sistemit elektronik të administrimit gjyqësor “*Legal Workflow*” (“LWF”), në pajtim me pjesën 5(1)(b) të Udhëzuesit dhe pjesën 2(5) të Udhëzimit të Zyrës Administrative për Kërkesat për Shërbime për Përkthim me Shkrim, e me Gojë dhe Verifikim (KSC-BD-14) (“Udhëzimi”).

¹⁰ Shih Parashtrimet e ZPS-së, para. 6-7, poshtëshënimi 12. Cilësimi i burimeve të jashtme mund të mbetet në dokument ose në materialin në fjalë.

¹¹ Shih Parashtrimet e ZPS-së, para. 4.

23. Nëse një shtojcë, material mbështetës ose provë tjetër përmban tekst në gjuhë tjetër nga anglishtja, Prokurori i Specializuar ose pjesëmarrësi, sipas rastit përcakton saktësisht çfarë dhe sa duhet përkthyer, duke saktësuar, sipas rastit, pjesën, faqen, paragrafin ose fjalinë relevante për t'u përkthyer, në *LWF/FLOW*, në të njëjtën kohë kur paraqet dokumentin përkatës për protokollim në pajtim me pjesët 5(1)(b), 5(1)(d), dhe 5(3)(a) të Udhëzuesit.

24. Duke pasur parasysh pjesën 5(2) të Udhëzuesit, Gjykatësi i Vetëm e ruan të drejtën të kërkojë nga NJP-ja, përmes NJAGJ-së, që të përkthejë elementë të tekstit që kërkojnë përkthim zyrtar në anglishte në këto situata:

(1) Në rastin kur Prokurori i Specializuar ose pjesëmarrësi, sipas rastit, ka ofruar vetëm përkthimin e pacilësuar të elementeve përkatëse të tekstit (shih paragrafin 20); ose

(2) Në rastin kur nuk është kërkuar përkthimi i një elementi të tekstit të paraqitur në një gjuhë tjetër nga anglishtja, por të cilin Gjykatësi i Vetëm e vlerëson me rëndësi për zgjidhjen e kërkesës ose çështjes.

25. Vendimi i dhënë më lart nuk është i formës së prerë sa i përket obligimit të Prokurorit të Specializuar për të paraqitur, nga fillimi, përkthimin në anglishte të çdo parashtrimi të protokolluar, përfshirë shtojcat, materialin mbështetës ose provat e tjera ¹² ose, në raste të tjera, të përcaktojnë shtrirjen e përkthimit të nevojshëm me saktësi.¹³

26. Duke pasqyruar paragrafin 17 më lart, u sillet në vëmendje Prokurorit të Specializuar dhe çdo pjesëmarrësi të mos paraqesin audiomaterial, videomaterial ose material nga Interneti pa transkriptim përkatës. Në raste kur nuk respektohen këto udhëzime, Gjykatësi i Vetëm ka të drejtë që ose:

¹² Shih më lart paragrafët 13 dhe 15.

¹³ Shih më lart paragrafin 23.

(1) të mos marrë parasysh referencat relevante në dokumentet e protokolluara, përfshirë shtojcat, ose materialin mbështetës ose provat; ose

(2) të kërkojë nga Prokurori i Specializuar ose pjesëmarrësi, sipas rastit, të paraqesë korrigjim të dokumentit të protokolluar, përfshirë shtojcat, ose materialit mbështetës ose provave, përfshirë transkriptimin e referencave relevante dhe përkthimin në anglishte të tyre.

3. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me përkthimet

27. Çdo mosmarrëveshje ose kundërshti sa i përket saktësisë së përkthimeve zgjidhet nga NJP-ja.

D. KLASIFIKIM

28. Ky vendim dorëzohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 82(1) të Rregullores për të mbrojtur konfidencialitetin e hetimit aktual. Parashtrimi aktual riklasifikohet kur ky kusht të ketë pushuar së ekzistuari, në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

IV. VENDIM

29. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

- a) Përcakton që anglishtja është gjuha e punës për procesin me numër KSC-BC-2018-01;
- b) Urdhëron Prokurorin e Specializuar të paraqesë çdo parashtrim, shtojcë ose material mbështetës ose prova tjera të paraqitura bashkërisht me

parashtrimin në pajtim të plotë me udhëzimet e hollësishme të përcaktuara më lart; dhe

- c) Urdhëron NJAGJ-në që të informojë çdo pjesëmarrës, sipas rastit, për udhëzimet për gjuhën, nëse parashtrimi, përfshirë shtojcat, ose material tjetër të paraqitur nuk është në pajtueshmëri me udhëzimet e përcaktuara në këtë vendim.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Vetëm

E enjte, 5 dhjetor 2019

Në Hagë, Holandë.